



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

Lënda: Informacion në lidhje me rehabilitimin social dhe riintegrimin e shtetasve të dënuar në prag lirimi ose pas liritimit.

**ZNJ.** \_\_\_\_\_

E nderuar,

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 47 prot. datë 15.07.2021, me anë të së cilës kërkonti informacion në lidhje me masat e ndërmarra nga bashkia Shkodër në lidhje me me rehabilitimin social dhe riintegrimin e shtetasve të dënuar në prag lirimi ose pas liritimit, sqarojmë që:

Veprimtaria e Bashkisë Shkodër në ushtrimin e detyrave funksionale në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të ofrimit të shërbimeve sociale në përgjithësi, bazohet në politika dhe dokumentë strategjikë të miratuar nga Këshilli Bashkiak, që shërbejnë si udhërrëfyes në punën tonë të përditshme me qëllim shtrirjen dhe mbulimin e nevojave për shërbime sociale cilësore dhe sa më afër komunitetit, në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

Në vitin 2016, për herë të parë në Bashkinë Shkodër, është krijuar Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit publik, me dy sektorët përkatës (Sektori i përfshirjes sociale, NJMF-së dhe Strehimit dhe Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit”, që mbulojnë detyrat funksionale dhe përgjegjësitë e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale.

Bashkia Shkodër, bazuar në vizionin e saj; “Shërbime sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”, ka ngritur në territorin e saj Qendrat Komunitare “Për familjen”, të cilat janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Deri tani janë të ngritura dhe në funksion 12 qendra komunitare; 7 në zonën urbane dhe nga një në njësitë administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Velipojës, Postribës, Rrethinave.

Qendrat komunitare “Për Familjen”, të shtrira në të gjithë territorin e saj, ofrojnë shërbime parashoqërore si informimi, orientimi, këshillimi, mbështetja psiko-sociale, shërbime në

familje; shërbime komunitare si mbrojtja e fëmijëve, fuqizimi ekonomik, programet e prindërimit, shërbimet arsimore, ri-integrimi në shkollë, shërbime të kujdesit dhe edukimit shëndetësor; shërbime të përkujdesjes alternative si kujdestaria familjare. Në njësitë e pambuluara me Qendër Komunitare ofrojmë shërbime sociale të lëvizshme

Në lidhje me bashkëpunimin me IEVP-të në juridiksionin e Bashkisë Shkodër, për hartimin e Programit të reabilitimit të personave të burgosur në prag lirimimi, nuk kemi patur asnjëherë një kërkesë zyrtare nga institucionet përkatëse për të na vënë në dijeni në kohë në lidhje me personat në prag lirimimi me qëllim që të hartohen programet e reabilitimit. Për herë të parë kemi një komunikim zyrtar në lidhje me adresimin e nevojave të kësaj kategorie me shkresë nr. 1563 prot. datë 14.05.2021 të IEVP Shkodër.

Gjatë kësaj periudhe struktura përgjegjëse e shërbimeve sociale ka qenë në kontakt me dy persona që kanë dalë nga IVEP dhe janë drejtuar në bashki për mbështetje. Këto raste janë trajtuar nga Qendra Komunitare “Për Familjen” që mbulon territorin e vendbanimit të qytetarit dhe pas vlerësimit të nevojave është relizuar dhe mbështetja me shërbimet e nevojshme.

Për rastet shtetasve të liruar nga IEVP duke përfshirë dhe shtetasit e gjinisë femërore, si fillim realizohet vlerësimi i rastit duke përfshirë dhe familjen e shtetasit, për të realizuar një program gjithëpërfshirës reabilitimi dhe riintegrimi. Kjo kategori trajtohet me prioritet në programet e strehimit social që zbaton Bashkia Shkodër.

Sa i takon fëmijëve në konflikt me ligjin, kemi bashkëpunim të ngushtë me strukturat ligjzbatuese, që në momentin e identifikimit të rastit si dhe në monitorimin e zbatimit të masave alternative për shmangje nga procedimi penal. Në këtë rast bashkëpunohet me Zyren vendore të Shërbimit të provës për të hartuar Planet individuale të ndërhyrjes dhe monitorimin e tyre. Masat alternative zbatohen në qendrat tona komunitare ku të miturit dhe familjet përkatëse përfshihen në programet e kujdesit social që ofrohen aty. Deri tani nuk kemi patur raste të të miturve në konflikt me ligjin në nevojë për strehim, por këto raste janë me prioritet nga sektori që mbulon strehimin social.

Mbështetja e shtetasve të liruar nga IEVP fillon me një vlerësim individual dhe të familjes dhe hartimin e Planeve të ndërhyrjes sipas nevojave të identifikuara. Shërbimet e ofruara janë informim, orientim, këshillim dhe referim drejt shërbimeve publike që ofrohen në territor si formimim profesional, punësim, pagesa të ndihmës ekonomike etj.

Në rastet kur vlerësohet ofrohet mbështetje psiko sociale, përfshirja në programe të fuqizimit ekonomik, programe prindërimit, strehimi etj.

Mbështetur në eksperincën e deri tanishme të punës në zhvillimin e shërbimeve sociale në nivel vendor në përgjithësi dhe veçanërisht për rehabilitimin social dhe riintegrimin e shtatasve të dënuar në prag lirimi ose pas lirimit rekomandojmë:

- Shkresën nr. 1563 prot. datë 14.05.2021 të IEVP Shkodër e vlerësojmë informacionin vetëm si fillimin e një procesi bashkëpunim në mes institucioneve, i cili duhet të zhvillohet me tej me vlerësime të tjera, sociale e psikologjike, etj, të shtetasve në prag të lirimit, si informacion të domosdoshme që IEVPV duhet të ndajmë me ne, për të përgatitur si duhet planet individuale të ndërhyrjes sipas nevojave.
- Për specialistët e shërbimeve sociale, ofrimi i shërbimeve për rehabilitimin social dhe riintegrimin e shtatasve të dënuar në prag lirimi ose pas lirimit, është një eksperience e re dhe vlerësojmë të domosdoshme trajnimin e tyre për të ofruar shërbime sa më cilësore.
- Gjithashtu mungesa e decentralizimit të plotë të shërbimeve sociale dhe veçanërisht mungesa e financimeve qeveritare të shërbimeve sociale për qeverisjen vendore mbetet sfidë dhe veshtirësi për planifikimin e shërbimeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve në nivel komunitar.

Deri tani nuk po zbatohet ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë”, nënvizojmë nenin 47 Fondi Social dhe Neni 48 Fondet e Financimit të këtij ligji, duke sjellë që të financojmë shërbimet vetem me burime vendore dhe të donatorëve, duke vënë në vështirësi krijimin, zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve me bazë komunitare.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

**KRYETAR**

**Voltana ADEMI**